



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

## STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

### “DIZENJIM MODE”

Niveli V në KSHK<sup>1</sup>, referuar niveli V të KEK<sup>2</sup>

D1-V-14

Ky Përshkrim Kualifikimi Profesional u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës



Projekt i financuar  
nga Bashkimi  
Europian



Projekt zbatuar nga  
Organizata  
Ndërkombëtare e  
Punës

Tiranë më, Dhjetor 2014

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	DIZENJIM MODE		Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK	D1-V-2014
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional <b>“Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK,</b> është të përgatisë krijues të kualifikuar në fushën e modës të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me krijimin, prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve, si dhe të zhvillojë jo vetëm personalitetin krijues, por edhe personalitetin e tyre si qytetarë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.</p>		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë kualifikim profesional në “Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kanë mbaruar arsimin e mesëm me drejtim artistik, dhe në profilet social kulturore;</li> <li>- Kanë mbaruar arsimin e mesëm të përgjithshëm “Gjimnaz”;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional;</li> <li>- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.</li> </ul>		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>–</li> <li>– Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Dizenjim mode”, niveli V në KSHK, referuar niveli V të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Suplementin përkatës, në këtë profil profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</li> <li>– Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve, në punishte të ndryshme artizanale dhe atelie mode apo të vetëpunësohet.</li> <li>– Individët mund të vazhdojnë studimet universitare, në fushën e modës dhe dizajnit.</li> </ul>		
Data e validimit			
Data e miratimit			
Variantet e mëparshme			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

**Rezultatet e të nxënit në:**

## NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode”, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

### Ngjyra në modë

- Të përshkruajë rëndësinë e ngjyrës në modë;
- Të shpjegojë psikologjinë e ngjyrës dhe aplikimet e saj në modë;
- Të shpjegojë raportin midis formës dhe ngjyrës në veshje dhe në krijimet e veta;
- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit nëpërmjet ngjyrës;
- Të përshkruajë rëndësinë e ngjyrës në suksesin e reklamës;

### Figurina dhe teknika grafike për ilustrim

- Të përshkruajë proporcionet anatomike të trupit të gruas, burrit dhe të fëmijëve;
- Të emërtojë hapat e punës që ndiqen për ilustrimin e krijimit në mënyrë dixhitale;
- Të përshkruajë elementët e “Artit dhe dizajnit”;
- Të Identifikojë elementët e dizajnit në fushën e modës;
- Të përcaktojë elementët dhe motivet për dizajnin e tekstileve;

### Teknologjia në modë

- Të listojë etapat e realizimit të figurinës dhe modelit të veshjes nëpërmjet programeve kompjuterike ilustrator dhe photoshop;
- Të listojë etapat e punës, për stampime serigrafike, nëpërmjet programeve kompjuterike ilustrator dhe photoshop;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe mënyrat e përdorimit të programit Adobe illustrator në fushën e dizajnit;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe mënyrat e përdorimit të programit Adobe photoshop në fushën e dizajnit;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të skedës teknike, nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike;

### Fotografia në modë

- Të shpjegojë rëndësinë e fotografisë në fushën e modës;
- Të Identifikojë kompozimin klasik dhe modern në fotografinë e modës;

### Marketing

- Të shpjegojë rëndësinë e testimit të tregut dhe hapat kryesore të tij;

- Të shpjegojë ciklin e jetës së produktit të modës;
- Të shpjegojë pozicionin e produktit të modës në treg;
- Të shpjegojë karakteristikat e target grupit të cilit i referohet produkti i modës;
- Të argumentojë hapat e ideimit për komunikim në media mbi produktin e ri në fushën e modës;
- Të përcaktojë elementët e duhur të reklamës së produktit në një konferencë shtypi;
- Të shpjegojë se si lind një markë veshjesh (zgjedhja e emrit, filozofia, target grupi, strategjia);

### **Industria krijuese**

- Të shpjegojë strukturën ekonomike dhe komerciale të produktit të modës;
- Të shpjegojë strukturën e sektorit prodhues;
- Të analizojë zgjedhjet e biznesit në fushën e modës;
- Të përshkruajë hapat e realizimit të projekteve artistike në industrinë krijuese;

### **Merceologjia e tekstileve**

- Të përshkruajë zhvillimin historik të tekstileve;
- Të identifikojë fibrat natyrale dhe artificiale;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të filaturës, të endjes dhe të hekurosjes së tekstilit;
- Të shpjegojë karakteristikat e tekstileve në fazën e projektimit të koleksionit;
- Të përshkruajë karakteristikat e tekstileve të përdorura për stampim dixhital në fushën e modës;

### **Modelimi industrial dhe konfeksionimi**

- Të shpjegojë teknika të ndryshme të modelimit (p.sh. modelim në manekin, modelim me kartë-model, etj);
- Të dallojë modele të larmishme të bazës së fundit, trupit, pantallonave, xhaketës;
- Të përshkruajë skemat e prerjes dhe paraqitjen grafike në mënyrë manuale dhe me ndihmën e teknologjisë informatike CAD;
- Të shpjegojë zbërthimin e modeleve realë;
- Të shpjegojë zbërthimin e kartëmodeleve të krijimeve të veta;
- Të shpjegojë hapat e prodhimit të veshjeve prototip për evente dhe sfilata;

### **Projektimi i koleksionit**

- Të shpjegojë karakteret dhe llojet e linjave të veshjeve;
- Të identifikojë forma të ndryshme stilistike;
- Të shpjegojë imazhe dhe ide krijuese;
- Të përshkruajë se si stili personal ndikon në mënyrën e projektimit të koleksionit;
- Të shpjegojë linjat e veshjeve për burra, femra, fëmijë nga konfeksionet industriale te moda e lartë (nga prêt à porter te haute couture);
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së imazhit të ideuar nga projekti te produkti;
- Të përshkruajë mënyrat e komunikimit me bashkëpunëtorët në fushën e modës;

## **Historia e modës dhe aspektet sociale të veshjes**

- Të përshkruajë zhvillimin historik të kostumit nga antikiteti deri në zhvillimet bashkëkohore të modës;
- Të shpjegojë zhvillimin e aksesoreve dhe bizhuterive në shekuj;
- Të identifikojë personazhet e mëdha të modës;
- Të përshkruajë tendencat dhe rëndësinë e tyre në krijim në fushën e modës;
- Të shpjegojë influencën e medias në fushën e modës;
- Të shpjegojë rëndësinë e fushatës së reklamës, koleksioneve të sofistikuara, fotografisë dhe teknologjinë, muzikën në komunikimin me publikun

## **Laboratori i projektimit**

- Të shpjegojë procesin e prodhimit të veshjes;
- Të shpjegojë procesin e qepjes së prototipit të veshjes;
- Të shpjegojë të gjitha etapat e projektimit të koleksionit, (elementët frymëzues, kërkimet ikonografike dhe stilistike, draft koleksioni dhe skicat teknike, kampionet e tekstilit, etj.);
- Të shpjegojë elementët e skedës teknike;
- Të përshkruajë trajtime të ndryshme të materialit të tekstileve: larja, ngjyrosja, stampimi, hekurosjë etj.

## **Laboratori i eksperimentimit**

- Të identifikojë materialet e reja tekstile në përdorim;
- Të përshkruajë rëndësinë e aplikimeve dhe trajtimeve eksperimentale të materialeve;

## **Manaxhim**

- Të përshkruajë mënyrën e menaxhimit të një biznesi mode;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit dhe monitorimit të punës;

## **Legjislacion**

- Të përshkruajë pronën intelektuale duke shpjeguar te drejtat mbi pronën;
- Të përshkruajë autorësinë si marrëdhënie Autor-Vepër duke shpjeguar përmbajtjen e së Drejtës së Autorit;
- Të përshkruajë legjislacionin mbi pronësi industriale;
- Të shpjegojë mbrojtjen në aspektin civil dhe në aspektin administrativ;
- Të përshkruajë legjislacionin për ndërmarrjet “Ligji për shoqëritë tregtare” në Shqipëri;
- Të përshkruajë legjislacionin e punës;

## **Mjetet e punës dhe materialet**

- Të listojë mjetet e punës dhe teknikat grafike manuale dhe dixhitale për procesin e krijimit;
- Të listojë mjetet e punës që përdoren për procesin e konfeksionimit të veshjeve;

- Të shpjegojë përdorimin e mjeteve të punës gjatë procesit të modelimit;
- Të identifikojë makinat e duhura për çdo proces të konfeksionimit të veshjeve;

### **Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit**

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në vendin e punës;
- Të shpjegojë kuptimin për “mjedisin”.
- Të argumentojë domosdoshmërinë e mbrojtjes së mjedisit.
- Të shpjegojë kuptimin e termit “Zhvillim i qëndrueshëm”.

### **Etika në komunikim**

- Të përshkruajë etikën dhe sjelljen profesionale;
- Të shpjegojë parimet bazë dhe etikën e komunikimit në një njësi biznesi;
- Të shpjegojë etikën në vendimmarrje.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Dizenjim mode”, individi do të zotërojë shprehitë profesionale të si më poshtë:

### **Ngjyra në modë**

- Të përdorë me profesionalizëm raportet e ngjyrës në projektimin e koleksionit;
- Të aplikojë njohuritë mbi psikologjinë e ngjyrës në projektimin e koleksionit;
- Të krijojë një raport harmonik midis formës dhe ngjyrës në projektimin e koleksionit;
- Të përdorë ngjyrën si një element të rëndësishëm të komunikimit në fushën e modës;

### **Teknologjia në modë**

- Të realizojë figurinën dhe modelin e veshjes nëpërmjet programeve kompjuterike ilustrator dhe photoshop;
- Të krijojë dizajnin e tekstileve, për stampime serigrafike, nëpërmjet programeve kompjuterike ilustrator dhe photoshop;
- Të përdorë programet Adobe illustrator dhe Adobe photoshop për të krijuar në fushën e modës;
- Të realizojë skedën teknike, nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike;

### **Figurina dhe teknika grafike për ilustrim**

- Të vizatojë saktë proporcionet anatomike të trupit të gruas, burrit dhe të fëmijëve, në figurinën e modës;
- Të përdorë me profesionalizëm materialet e punës dhe teknikat grafike për ideimin e

koleksionit;

- Të përdorë programet dixhitale për ilustrimin e figurinës së modës;
- Të përdorë elementët e artit dhe dizajnit në projektimin e koleksionit;
- Të përdorë elementet e artit dhe dizajnit në mënyrë krijuese dhe inovatore;
- Të krijojë dizajnin e tekstileve si nëpërmjet mjeteve tradicionale ashtu edhe me ato dixhitale;

### **Fotografia në modë**

- Të ideojë situatën e favorshme fotografike për realizimin e setit fotografik;
- Të realizojë fotografi të koleksionit në përshtatje me idenë;
- Të Identifikojë kompozimin klasik dhe modern në fotografinë e modës;
- Të përdorë fotografinë, si pjesën më të rëndësishme të reklamimit të koleksionit;

### **Marketing**

- Të hartojë ciklin e jetës së produktit të modës;
- Të testojë pozicionin e produktit të modës në treg;
- Të projektojë koleksionin duke iu referuar një target grupi të caktuar;
- Të përgatisë argumentet e duhur për komunikim në media elektronike dhe të shkruar, mbi produktin e ri në fushën e modës;
- Të përdorë elementët e duhur të reklamës së produktit në një konferencë shtypi;
- Të organizojë prezantimin e një koleksioni apo produkti në publik (sfilata, ekspozita, panairë, fletëpalosje, katalog, etj.);

### **Industria krijuese**

- Të organizojë strukturën e sektorit prodhues
- Të vlerësojë strukturën ekonomike dhe komerciale të produktit të modës;
- Të zbatojë zgjedhjet e biznesit në fushën e modës;
- Të realizojë projekt koleksionin në industrinë krijuese;

### **Merceologjia e tekstileve**

- Të përdorë karakteristikat e fibrave tekstile në përshtatje me idenë e projekt koleksionit;
- Të përdorë fibrat tekstile në mënyrë krijuese për të sjellë risi në fushën e modës;
- Të përshtatë karakteristikat e fibrave tekstile me elementët e dizajnit dhe modës;
- Të përshtatë karakteristikat e fibrave tekstile me dizajnin e përdorur për stampimin dixhital;
- Të përdorë karakteristikat e endjes së fibrave tekstile për ide krijuese;

### **Modelimi industrial dhe konfeksionimi**

- Të përdorë teknika të ndryshme të modelimit (p.sh. modelim në manekin, modelim me kartë-model, etj);
- Të zbërthejë modele të larmishme të bazës së fundit, trupit, pantallonave, xhaketës;
- Të realizojë skemat e prerjes dhe paraqitjen grafike në mënyrë manuale dhe me

ndihmën e teknologjisë informatike CAD;

- Të realizojë kartëmodelet e krijimeve të veta;
- Të realizojë hapat e prodhimit të veshjeve prototip për evente dhe sfilata;

### **Projektimi i koleksionit**

- Të përzgjedhë karakteret dhe llojet e linjave të veshjeve për projekt koleksionin;
- Të krijojë një stil personal;
- Të hulumtojë imazhe dhe ide krijuese;
- Të krijojë linjat e veshjeve për burra, femra, fëmijë (prêt à porter - gati për tu veshur);
- Të realizojë veshjen prototip duke ruajtur maksimalisht imazhin e ideuar nga projekti te produkti;
- Të krijojë portofolin personal sipas standardeve të industrisë;
- Të komunikojë me bashkëpunëtorët në fushën e modës për projektimin e koleksionit;

### **Historia e modës dhe aspektet sociale të veshjes**

- Të përdorë elementët e historisë së modës në veshjet bashkëkohore;
- Të përdorë elementët e historisë së aksesorëve dhe bizhuterive në shekuj, në konceptimin bashkëkohor të tyre;
- Të përdorë tendencat e modës në projektimin e koleksionit;
- Të investigojë influencën e medias në fushën e modës;

### **Laboratori i projektimit**

- Të ndjekë procesin e prodhimit të veshjes;
- Të projektojë koleksion duke ju përgjigjur filozofisë, target grupit dhe strategjisë së një marke të caktuar;
- Të realizojë të gjitha etapat e projektimit të koleksionit, (elementët frymëzues, kërkimet ikonografike dhe stilistike, draft koleksioni dhe skicat teknike, kampionet e tekstilit);
- Të ndërtojë skedën teknike të elementëve përbërës të koleksionit;
- Të kryejë trajtime të ndryshme të materialit të tekstileve: larja, ngjyrosja, stampimi, etj.

### **Laboratori i eksperimentimit**

- Të analizojë materialet e reja tekstile në përdorim;
- Të eksperimentojë aplikime dhe trajtime të materialeve të ndryshme mbi veshjet dhe aksesorët;
- Të realizojë produktet e reja të modës;
- Të ideojë aksesorë të tillë si kapele, këpucë, sandale, çanta, rripa, etj.
- Të modelojë aksesorëve të tillë si kapele, këpucë, sandale, çanta, rripa, etj., me materiale të buta, të riciklueshme, etj.

### **Manaxhim**

- Të menaxhojë një atelie mode;



- Të organizojë dhe monitorojë punën brenda një biznesi mode.

### **Legjislacion**

- Të respektojë legjislacionin shqiptar dhe standardet në fuqi për aspekte të ndryshme të ekonomisë;
- Të respektojë legjislacionin shqiptar dhe standardet në fuqi për aspekte të ndryshme në fushën e modës;

### **Mjetet e punës dhe materialet**

- Të përdorë me profesionalizëm mjetet e punës dhe teknikat grafike, manuale dhe dixhitale, për procesin e krijimit;
- Të përdorë me profesionalizëm mjetet e punës gjatë procesit të modelimit;
- Të përdorë makinat e duhura qepëse, për punë specifike, gjatë procesit të konfeksionimit të veshjes.

### **Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit**

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në vendin e punës.

### **Etika dhe komunikimi në biznes**

- Të hartojë dokumente pune, formularë biznesi dhe tekste;
- Të krijojë raporte njerëzore dhe profesionale për sukses në vendin e punës dhe jashtë tij;
- Të sillët në mënyrë etike gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të llogarisë me saktësi rezultatet e analizave duke përdorur aftësitë matematikore ;
- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;

- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.